



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02-060/01-0059372-1/24 dt. 12.09.2024

Mitrovicë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja e 32

Koha: 12.09.2024 ora 10:00

Vendi: Salla e Mediave

Të pranishëm: Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza
Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Fadil Veseli, Nazmije Sejdiu, Vesel Neziri, Shkurta Shosholli Musa, Hysen Muzliukaj, Erseka Barani, Muhamed Hoti dhe Xhyljeta Imeri

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza
Drejtorët e Drejtorive

Mungoi:

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja e cila theksoi se në zbatim të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; nenit 11 paragrafët: 1, 2 edhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë; nenit 62, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenit 15, pika 2, të Rregullores Komunale për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës, për sot ka thirrur mbledhjen e 32-të të Komitetit për Politikë dhe Financa, me këtë rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Draft Buxheti për vitin 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026-2027
3. Propozim-vendim për anulimin e vendimit Nr. 02/060/01-0029209/21-3 i dt 29.04.2021
4. Propozim-vendim për këmbimin e pronës të paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të Arsi Company Sh.p.k
5. Propozim-vendim për këmbimin e pronës të paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të Arsi Company Sh.p.k duke përfshi dhe objekti për banim/afarizëm
6. Propozim-vendim për këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të personit fizik Blerim Emini

7. Propozim-vendim për miratimin e ndryshimit të emërtimit të shkollave të mesme të larta profesionale në Institucionet e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional-IAAP

Rendi i ditës u miratua unanimisht.

Pika 1

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimisht.

Pika 2

Kryesuesja znj. Vesa Broja para se të hapë diskutimin lidhur me Draft Buxhetin për vitin 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026-2027 për ta arsyetuar të njëjtin fjalën ia kaloi drejtoreshës së DBF-së znj. Igballe Islami.

Igballe Islami: Kam kënaqsin sot para jush të prezantojmë draft-buxhetin për vitin dy mijë e njëzet e pesë si dhe parashikimet për vitin dy mijë e njëzet e gjashtë dy mijë e njëzet e shtatë. Vlen të theksohet që ky buxhet është hartuar dhe është punuar duke i respektuar qarkoren buxhetore 2025/01 dhe 2025/02, duke respektuar udhëzimet administrative mbi prioritetizimin e investimeve kapitale. Andaj përfundimisht, me Qarkoren Buxhetore 2025/02, Komuna e Mitrovicës si organizatë buxhetore ka buxhet prej tridhjetë milionë e dyqind e katërdhjetë mijë e pesëqind e dymbëdhjetë euro. Ky buxhet është ndarë në kategoritë ekonomike, duke i respektuar gjithmonë qarkoret buxhetore, gjashtëmbëdhjetë pikë një milion në paga dhe mëditje, katër pikë tetë milionë mallrat e shërbime, gjashtëqind mijë shpenzime komunale, subvencione dhe transfere një pikë dy milionë dhe shpenzimet kapitale shtatë pikë katër milionë euro. Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka mbajtur gjithsej katër dëgjime buxhetore me qytetarët, ku kemi pranuar kërkesat dhe nevojat e tyre. Vlen të potencohet që rëndësi e veçantë i është dhënë mbulimit të obligimeve kontraktuale, pra mbulimit të obligimeve nga kontrata të kornizë, të cilat janë aktive në Komunën e Mitrovicës, si dhe duke pas parasysh që kërkesat, nevojat e qytetarëve janë të mëdha, ne kemi prioritetizuar ato duke respektuar së pari obligimet kontraktuale. Unë çka kam dëshirë sot me shtu këtu është që për arsye që disa procedura të prokurimit të cilat kanë qenë në fazën e vlerësimit, tanimë janë edhe në fazën e nënshkrimit të kontratave, dhe ne na është dashur që të bëjmë një plotësim sa i përket kategorive ekonomike kapitale në disa projekte. Gjithashtu, për shkak se sistemi BDMS është sistemi domethënë i cili futet buxheti, ka pësuar ndryshime, ndryshime ka me pasë edhe në kategorinë e pagave, për arsye që BMS-ja si e tillë ka ndryshuar, edhe neve na duhet me i harmonizua buxhetin nëpër programe, varësisht se si e kërkon BMS-ja në sistem. Sa i përket kategorisë mallra dhe shërbime, nga kategoria mallra shërbime nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, nga të hyrat, dyqind mijë euro do transferohen - do të barten edhe në drejtorinë komunale të arsimit për mbulimin e shpenzimeve për inventarizimin e çerdheve, të cilat janë vetëm në fazën e përfundimit. Sa i përket projekteve kapitale ka me pasë ndryshime, domethënë plotësime të disa projekteve, të cilat janë në fazën e nënshkrimit të kontratave e ato do të barten nga Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit dhe pusetave, pesëdhjetë mijë euro minus janë. Ndërtimi i rrugëve në fshatin Bajgor minus pesëdhjetë mijë euro, rregullimi i shtratit të lumit Trepça minus pesëdhjetë mijë euro, ndërtimi i rrugës në Stantërg minus njëzet mijë euro, pajisje mjekësore për QKMF-në e re minus njëzet mijë euro, dhe rregullimi i objektit të muzeut minus tridhjetë mijë euro. Këto mjete do të plotësohen në projektet e Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në ndërtimin e çerdhes për fëmijë në fshatin Këq i Madh do të shtohen pesëdhjetë mijë euro, në vitin dy mijë e njëzet e pesë ndërtimin e çerdhes për fëmijë në lagjen Ura e Gjakut, Vaganicë pesëdhjetë mijë euro do të shtohen në rregullimin e objektit SHFMU njëqind e nëntë mijë euro, si edhe në ndërtimin e infrastrukturës nga oborret e shkollave fillore dhe të mesme do të shtohen edhe nëntëdhjetë e tre mijë euro, prej asaj të cilën e keni pranë ju si draft. Domethënë, këto janë plotësim-ndryshimet, andaj unë kërkoj që me pas mirëkuptimin tuaj, edhe krejt këto ndryshime kanë ndodhë për arsye që nga momenti kur është procesu material për Kuvendin Komunal, kanë pësuar edhe ndryshimet dhe domethënë kanë vazhduar procedurat e vlerësimit në prokurim. Kështu që kërkoj që ky draft të votohet me këto ndryshime që unë i propozova dhe materiali me plotësim ndryshime do t'ju vijë edhe i njëjti duhet me u shqyrtuar edhe

në seancën e kuvendit komunal. Po ashtu janë edhe dy projekte të reja, të cilat nuk janë pjesë e listës: do të shtohet shuma në vlerë 30.000 € për mbulimin e obligimeve që kemi sipas marrëveshjes me fondin e eficiencës si dhe projekti tjetër, projekti i rrugës “Lah Nimani”, me qëllim pagesën e shpenzimeve, me rastin e shpronësimeve, të cilat do të ndodhin për hapjen e kësaj rruge.

Fadil Veseli: Në vija të trasha na u sqarua, unë nuk kam vërejtje mirëpo sa i përket kategorive të ndarjes, kategorive ekonomike, është mjaft i përpunuar në mënyrë profesionale, prioritet është tash sfida më e madhe se çka mund të kryhet e çka jo, në këtë rast ekzekutivi duhet me qenë shumë i kujdesshëm, meqenëse ekzekutivi është pak më shumë në ngjarje rreth rrjedhave, kërkesave, mirëpo edhe ne si anëtarë, tash buxhetin edhe investimet i shohim nga këndi tjetër, prej nga kanë ardhë, p. sh. unë e propozoj një projekt sot atëherë duhet të shiqohet se cilin projekt të largohet. Mirëpo telashi i madh është tash se cilin projekt me hekë tash prej kësaj linjës, se buxheti në njëfarë forme në vija të trasha, veç se është i kufizuar. Çerdhja e fëmijëve në ekzekutivin e kaluar disa vite radhazi ka figuruar në buxhet ndërsa çerdhja nuk ishte askund. Me këtë po dua të them që disa proejkte po lindin telashe sidomos me Minsitri dhe Komunë, këtu po shihet që diqka nuk po funksionon se mos të ndërtohet një çerdhe për 5 vite dhe çdo vit të bartët buxheti nga viti në vit kjo të jep me kuptu që diqka nuk është në regull. Po nuk është vetëm ky projekt që ka telashe me relaizim, e kam fjalën kur është bashkëpunimi me Ministrinë, andaj kërkoj që ekzekutivi në këto pika të jetë më i kujdesshëm. Sa i përket prioritetetve të investimeve, te investimet kapitale, meqenëse drejtori nuk është këtu unë kam një shqetësim për fshatin Broboniq, në Broboniq janë bërë punë shumë mirëpo në atë rrugicë për të cilën e kam fjalën po e ngris si shqetësim se tash fillon viti shkollor dhe fëmijët në atë rrugë kalojnë aty, uji dhe ujërat e zeza kanë dal në sipërfaqe andaj shpresoj që qeveria te rregullojë këtë. Një tjetër shqetësim e kam për ujërat e zeza, kanalizimet, sot janë bërë të padurueshme kërkoj që të investohet dhe kërkoj prap që ekzekutivi të jetë i kujdesshëm dhe të investohet më shumë në ato lagje ku janë banorët e jo në ato pjesë ku banorët shkojnë vetëm për vikende.

Muhamed Hoti: Kur keni filluar me këtë qeverisje dhe me këtë kolegialitet, se është përgjegjësi edhe jona që jena pjesë e opozitës, keni hy këtu me ca premtime dhe ne duhet të ju dalim zot dhe duhet edhe t'i mbrojmë. Sa i përket këtij draft buxheti të vitit 2025 unë i kam disa pyetje se çka dallojnë premtimet tona që i keni bërë, duke e përfshi veten së bashku me juve nga diskutimet publike që i keni pranuar prej kërkesave të tyre?, cili është dallimi mes dy palëve?, dhe a është bënë ndonjë narrativë se çka e karakterizon këtë buxhet, shembull të vitit 2025 me ato që i kemi lënë pas, a është bënë ndonjë racionalizim, për shembull, i shpenzimeve, se si keni p.sh. me krijuar të hyra vetanake. Qysh të arrijmë të nxjerrim borxhet që i keni. Këto janë brengat e mija si anëtari i KPF-së, me një fjalë unë po e shoh se planifikimet nuk janë duke shkuar bashkë për shtati me u realizuar ato që janë planifikuar, domethënë po kemi një shpenzim, që tregon se është një shpenzim që është dal jashtë planit të realizimit. Unë kam shumë çka për të diskutuar, nuk po dua me qenë politik brenda Kuvendit, po dua m'i jep sugjerimet e mia, të cilat ndoshta munden me u interpretuar si lloj kërkesë, po prapë se prapë Mitrovica është për të gjithë, po secili kemi hise këtu dhe të paktën të bëjmë nga një punë të mirë. Unë kam pa planifikimet që i keni bërë në vitin 2024 dallojnë me këto që i keni bërë në vitin 2025 dhe dallojnë bukur shumë ka ana e vlerës financiare. Ka pasur raste, dy-tri shembuj po i marrë për shkak që mos me zgjatë shumë, planifikimet që i keni bërë, shembull tek lagja “Ali Zeneli”, e keni bërë një vlerë shembull të investimit 390.000 €, kur u përmbledh për vitin 2024 s'e di sa kemi arrit me realizua atë, kemi planifikuar që këtë vit me i bërë 350.000€, ku jeni me planin e vitit të kaluar edhe me këtë vit që keni planifikua me bërë, pra më intereseon se ku jeni me punë.

Veseli Neziri: Është hera e gjashtë që po investohet në rrugën e Tërstenës, edhe në mandatin e kaluar është investuar, propozoj që nëse nuk ka asfalt që të punohet në atë rrugë kërkoj që ai investim prej 30.000 € të kalon te ndonjë projekt tjetër, arsyeja është se ajo punë që bëhet me zhavor në momentin që po ka reshje të shiut dy herë radhazi krejt ajo punë po shkon dëm. Mendoj që më mirë është që të presim 2 vite dhe kur të investohet në atë rrugë të bëhet investim i duhur me asfaltim, se sa kështu të shkojnë mjetet kot. Një kërkesë tjetër e kam për ju Kryetar, don Zoti të bëheni Kryeministër, pra në qoftë se bëheni kryeministër atëherë kërkesa ime është që fshati Tërstenë që vërtet e meriton me u trajtua si një Fshat Muze, është i vetmi fshat në Kosovë ku të gjitha shtëpitë janë të djegura dhe asnjëra shtëpi nuk është ndërtuar pra do të ishte në interes të Kosovës.

Xhylljeta Imeri: Së pari, kam tri pyetje, e mandej i kam disa kërkesa: A mund të na tregoni se deri ku ka shkuar procesi në lidhje me shkollën “Aziz Sylejmani” - aneksi në paralelen tonë në Suhodoll, çerdhen në Shipol, ku është procesi për funksionalizimin e saj, si dhe për oborrin e shkollës “Abdullah Shabani”, kurse një kërkesë që besoj që është shumë e rëndësishme dhe e pranueshme për të gjithë, edhe insistoju në këtë kërkesën time, nuk është e imja personalisht për vete, por është për fëmijët tanë, për cilindo, për talentët e rinj, të kenë subvencione Drejtoria e Arsimit, kur ka subvencione Drejtoria e Shëndetësisë edhe Bujqësisë, pse mos ketë Drejtoria e Arsimit, që besoj që është bazament i secilit prej neve. Nëse ne nuk kemi arsim në atëherë nuk kemi as shëndetësi, as bujqësi, as njërën lëmi të vetme ne nuk mundemi me zhvilluar. Kemi pasur raste nxënëse me talente si p.sh. matematikë dhe fizikë ku ne kemi shumë mungesë të kuadros të këtyre lamive, nuk kemi pas mundësi asnjë cent të ndani si komunë. Unë e kuptoj jo përse ju s'keni deshtë, po nuk kanë qenë të planifikume dhe të ndame. Për këtë arsye unë kërkoj që të ndahen mjete që edhe Drejtoria e Arsimit të ketë subvencione për fëmijët talent, kur po marrin pjesë nëpër gara pse mos t'i mbështesim. Nëse ne i mbështesim ata, do të jetë motiv dhe frymëzim edhe për nxënësit tjetër. Në këtë planifikim buxhetor u pa që nuk ka ndarje të mjeteve për kabinete shkollore, për tabela digjitale, ju kuptoj, për arsyet që keni, janë disa planifikime në investime kapitale, por uroj që çerdhet në Këqç, te Ura Gjakut edhe një ku ishte nuk po më kujtohet, uroj mos te kenë fatin e çerdhes të Shipolit! Kështu që kam edhe disa çështje tjera, ku kërkesat e qytetarëve, është një numër prej 170 kërkesave, ishin vetëm dyzet e diçka, apo tridhjetë e diçka, se e kam gabuar ndoshta numrin, janë të premtuara por jo të realizuara, andaj pres që së paku këto që janë të planifikuara të realizohen edhe kjo kërkesë e imja në emër të gjithë fëmijëve të Mitrovicës për subvencionimin e tyre për talentin e tyre të aprovohet.

Erseka Barani: Sa i përket subvencionimit në Drejtorinë e Shëndetësisë për këtë vit, dmth për 2024 kanë qenë të ndara 100.000 €, ndërsa për vitin e ardhshëm janë të planifikuara 80.000 €. Mua po më intereson pse është ky zvoglim i planifikimit, a ka ulje të kërkesave të qytetarëve apo çka. Njëkohësisht pyetja tjetër ka të bëjë me rregullimin e oborrit të Shkollës “Abdullah Shabani” e përmendi edhe parafolësja vitin e kaluar për tri vite kanë qenë të planifikuar 450.000 €, ndërsa tash jemi në shtator, gati në tetor dhe nuk ka asnjë fillim të procesit ose të procedurave për rregullimin e atij oborri, kisha kërkuar që Drejtoria e Arsimit apo dikush nga Kabineti të del dhe ta sheh oborrin e shkollës se me të vërtetë është në gjendje të keqe, në momentin që ka reshje shiu oborri mbushet me ujë, fëmijët po rrëzohen dhe pastaj ata spo mundën me mbajt procesin mësimor. Po ashtu më intereson se në bazë të raportit që e pamë nga dëgjimet buxhetore një kërkesë e madhe e grave ndërmarrëse dhe start up bizneseve ishte që me i subvencionuar me pajisje, nuk e di në cilën prej kategorive e keni përfshi subvencionimin e atyre grave edhe a janë të përfshira kërkesat e tyre.

Kryetari Bedri Hamza: Fillimisht të dëshiroj t'i falënderoj të gjithë anëtarët e KPF-së për kontributin e tyre, për diskutimet e tyre shumë profesionale dhe përmbarjtësore, është mirë që jemi anëtarë të më shumë partive politike. Asnjëherë në këtë Komitet nuk kam pasur rast me dëgjua fjalime të cilat s'kanë qenë në interes të qytetit dhe qytetarëve. Po bëj përpjekje në mënyrë telegrafike, veç me i dhënë disa sqarime në disa çështje shumë të rëndësishme që u ngritën. Z.Hoti e ngriti çështjen e të hyrave, në gjykata, kur paditet komuna, në procedurë të përshpejtuar vijnë në radhë me naj marrë parat, edhe në mes këtij mandati, pa fajin tim si kryesues i kësaj organizate buxhetore, realisht mbi 10 milionë e sa po bjen që kemi paguar obligime përmes procedurave përmbarimore, pjesa e madhe absolut nuk lidhet me punën e komunës, ka të bëjë me kontratat kolektive në arsim-shëndetësi, mirëpo ka edhe obligime të prapambetura që janë bartë prej të kaluarës, mirëpo për neve kur po duhet me i pagu veç këtë vit i kemi paguar diku rreth tre milionë e gjysmë. Po ndodhin dy të këqijat, neve po na ndërhyjnë në projekte dhe e dyta, sa ka qenë e vështirë me e marrë opinionin e pakualifikuar të auditorit për vitin 2023 ndërsa për vitin 2024 krejt lehtë mundet me ta kualifiku, pse thotë ke bo keqklasifikim, po është keqklasifikim për shkak se është urdhër përmbarimor nuk më ka pyetur askush, ka hy dhe i ka marr mjetet. Prandaj, po të kufizon, po kur po është në pyetje na me i realizua drejtat tona, ne kemi procedura në gjykata, më besoni që është numër simbolik i lëndëve të cilat janë trajtua por milionat janë në pyetje. Ndërsa pa një vendim përfundimtar të gjykatës, nuk po mundesh me i inkasu. Rreziku tjetër është se këto e kanë edhe afatin e parashkrimit mbi bazën e Ligjit për marrëdhëniet detyimore, dhe, mungesa e të hyrave, pastaj po vijmë atje ku i përmende ato çështje që i përmende. Z.Neziri sa i përket Tërstenës nuk besoj që duhet me u hekë, por mjetet duhet me u shtu. Edhe jam njëqind për qind

në linjë me ty që në konfiguracione të caktume të terrenit mos të qitet zhavorr, e theksuat edhe ju një herëdy bie shi bartet zhavori krejt, prandaj kjo duhet me u asfaltu, po për si kod duhet me mbet dhe në fund të vitit nuk ka teori pa pasur të hyra të bartura, nuk e di në këtë moment sa, por në fund të vitit kemi pasur të hyra të bartura dhe ato të hyra të bartura mundesh me i plotësua edhe me e rrit shumën, a unë po të premtoj, që jam kësajde kam me ju përmbajt kësaj, tek ky kod kanë me u rrit mjetet edhe rruga ka me u bë. Znj. Imeri i ngriti fillimisht tri pyetje shumë të rëndësishme. Aneksi i shkollës “Aziz Sylejmani” mjetet janë nda, dua të besoj që lidhet kontrata. Te çerdhja e Shipolit kam me mbajt në mend sa të jem gjallë sikurse edhe disa projekte tjera siç janë: rr. “Ali Zeneli” rr. “Lahni Nimani”, hekat që i kam pasur, ju disa i dini por jo krejt se nuk keni pasur mundësi, po ashtu Urën te Liqeni, Shkollën në Gushavcit, ndërsa peng do të më mbetet nëse nuk do të mund ta realizoj projektin e Shkollës së Muzikës dhe renovimin e Gjymnazit me i pas mjetet, e mos me mujtë me i nis punët, boll gazep, herë shkon në OSHP, ankohet njëri, kthehet e shpall tjetrin, ankohet tjetri, realisht, ligjërisht, na shpeshherë po vijmë në situatë me vepru se s'po të përgjigjet brenda afateve ligjore kështu që si nuk të përgjigjet brenda afateve ligjore, ti ke të drejtë me vepru. Prandaj, çerdhja, përfundimisht u lidh kontrata dhe besoj që javën e ardhshme fillojnë punimet me u finalizua. Çerdhja e Shipolit, çerdhja e Desit, shiko ka ndërrua situata, pse jam fokusuar në çerdhe shumë në Mitrovicë edhe uroj që në mandatin e ardhshëm kushdo qeverisë me pas kujdes me i funksionalizuar, jo veç me i ndërtua, se ato dojnë staf, dojnë pajisje, dojnë inventarë i dojnë të gjitha. Po pse? Sot, nënat e reja kanë nevojë për punë. Çerdhe private, është dallimi në çmim tre fëmijët nga 100€, bëjnë 300€ për muaj dhe kjo është e rëndë. Prandaj mendoj që nëse kompletohet Infrastruktura te “Gëzimi ynë” Shipoli, te desi, te ura e gjakut, kqijç, mendoj që për Mitrovicën është numër i mjaftueshëmi çerdheve. Shqipoli definitivisht edhe përfundimisht jam i gëzuar dhe uroj që ta ketë fitu naj kompani që kryen punët, nuk e di se kush, po uroj që ta përfundoj brenda këtij viti. Te Desi, unë besoj që është ardhë në fazën e nënshkrimit të Kontratës, te Ura e gjakut, në kqijç janë procedurë në fazën finale, nuk u ardh hala te nënshkrimi. Te oborri i shkollës janë mjetet për të, duhet me u rregullua edhe mendoj që kontrata i ka kalu fazat dhe javën e ardhshme me u nënshkrua për rregullimin e oborrit në shkollën “Abdullah Shabani”. Por të jemi të sigurtë, aty ka nevojë të ndërtohet komplet shkolla. Edhe në fund, u përmend subvencionimi në arsim, realisht kam dëshirë me i ndihmu edhe sportit, edhe kulturës, po për mua investimi në arsim është investimi më i duhur, më i drejtë. Prandaj, drejtoreshë ndajë 50.000 € te arsimit për subvencionim, edhe hjeti te kultura.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim Kryesuesja vuri në votim Draft Buxhetin për vitin 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026-2027, të plotësuar me propozimet e anëtarëve të KPF-së.

Draft Buxheti për vitin 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026-2027 u miratua unanimisht (7-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 3

Kryesuesja znj. Vesa Broja para se të hapë diskutimin lidhur me me Propozim-vendimin për anulimin e Vendimit Nr. 02/060/01-0029209/21-3 i dt 29.04.2021 për ta arsyetuar të njëjtin fjalën ia kaloi Drejtorit të Katastrit z. Artan Berisha.

Artan Berisha: Parajush kemi sjell Propozim-vendimin për anulimin e Vendimit të datës 29.04.2021 që ka të bëjë me këmbimin e një prone të z. Agron Sadiku dhe pronës komunale, e cila nuk është implementuar deri në fund dhe e kemi parë të arsyeshme ta anulojmë. Për këtë arsye kemi sjellë para jush edhe besoj që arsyetimi është i shkruar dhe nëse dikush e ka të paqartë mund të përgjigjem.

Edison Tmava: Veç shkurtimisht me plotësua, zona ku është e këmbyme është edhe më hartë zonale e destinuar për ndërtimin e çerdhes për lagjen e Bairit, dmth në pjesën naltë, d.m.th. ky ke si plotësim dhe kjo ka qenë arsyeja për anulim.

Pas arsyetimit nga ana e ekzekutivit, Kryesuesja e mbledhjes hapi diskutimin.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim Kryesuesja vuri në votim Propozim-vendimin për anulimin e Vendimit Nr. 02/060/01-0029209/21-3 i dt 29.04.2021.

Propozim-vendimi për anulimin e Vendimit Nr. 02/060/01-0029209/21-3 i dt 29.04.2021 u miratua unanimitisht (7-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 4

Kryesuesja znj. Vesa Broja: Sa i përket pikës së 4, 5 dhe pikës të 6 nëse pajtoheni po e hap diksutimin për të tri pikat ndërsa votimin e bëjmë veç e veç.

Fadil Veseli: Meqenëse s'i lloj pyetjeje, po shpresoj që tjera prona s'ka që kanë nevojë mu shpronësu, fjala është për rrugëm Ali Zeneli.

Kryetari Bedri Hamza: Veç të sqarojmë, do të thotë, hjeket kjo pjesa afërsisht një ari që është tek mishtorja, edhe zhvendoset aty afër, domethënë veç zhvendoset. Lirohet prona e Hakajve, po jo byrektorja, Hakajt, që është një pjesë aty mbrapa, edhe kjo e krijon hapësirën që projekti mu realizuar edhe rruga, edhe trotualet, edhe qasja pa asnjë pengesë. Shkolla e muzikës po e theksoj, parcela ku është e dedikuar për mu ndërtua shkolla e muzikës, nuk preket. Edhe sa unë jam Kryetar i komunës, ajo mundet me u përdor veç për ndërtimin e shkollës së muzikës, jo për diçka tjetër. Nuk ka pengesa për me u realizua punimet deri në fund ku janë familjet e Gërxfhalive, deri atje, edhe në atë anën mbrapa, e pastaj ka mundësi me u kry për me u lidhë andej nga universiteti, te Gërxfhallitë është çështja në gjyq, goxha komplekse, po me u çelë kjo pjesë këndeje dhe ajo në anën tjetër, pastaj vështirësitë në atë në atë rrugë janë minimale. E theksova z. Fadil që tek shtëpitë e doktorëve, një pjesë e tyre kanë hy në këmbim të pronave, me këta ndërtimtarë, janë edhe disa që janë tu negociu, por unë besoj që po flasim prej kësaj rrugës "Ferat Draga" që kthehet aty, del edhe deri te Gërxfhallitë. Ato kanë me qenë në trajtim por sigurisht nuk vjen për këmbim, por hyn në koeficient të ndërtimit me ndërtimtarë.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim Kryesuesja vuri në votim Propozim-vendimin për këmbimin e pronës të paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të Arsi Company Sh.p.k.

Propozim-vendimi për këmbimin e pronës të paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të Arsi Company Sh.p.k. u miratua unanimitisht (7-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 5

Kryesuesja vuri në votim Propozim-vendimin për këmbimin e pronës të paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të Arsi Company Sh.p.k

Propozim-vendimi për këmbimin e pronës të paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të Arsi Company Sh.p.k duke përfshi dhe objekti për banim/afarizëm u miratua unanimitisht (7-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 6

Kryesuesja vuri në votim Propozim-vendimin për këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të personit fizik Blerim Emini.

Propozim-vendimi për këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të personit fizik Blerim Emini u miratua unanimitisht (7-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 7

Kryesuesja znj. Vesa Broja hapi diskutimin lidhur me Propozim-vendimin për miratimin e ndryshimit të emërimit të shkollave të mesme të larta profesionale në Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional-IAAP.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim Kryesuesja vuri në votim Propozim-vendimin për miratimin e ndryshimit të emërimit të shkollave të mesme të larta profesionale në Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional- IAAP.

Propozim-vendimi për miratimin e ndryshimit të emërimit të shkollave të mesme të larta profesionale në Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional- IAAP u miratua unanimisht (7-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.


Mbledhja përfundoi punimet në ora 11:20 min.

Mitrovicë

Procesmbajtës:


Afërdita MAXHUNI

Kryesuesja e Kuvendit


Vesa BROJA

